



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	21.01.2025
REFERENC-Ë:	24/6068/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Fariz Mazrek" B.I. Mamushë, Prizren
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar kërkesën për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga kompania e Juaj me nr.prot.: 24/6068/627/DMMU, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi për Përfundim të procedurës administrative të kërkesës së Kompanisë "Fariz Mazrek" B.I. Mamushë, Prizren- për depon e naftës "Po Petrol" në Mamushë.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08//L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958/23 datë 13.07.2023), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Përfundim të procedurës administrative të kërkesës së kompanisë "Fariz Mazrek" B.I. Mamushë, Prizren, e cila ka aplikuar për tu pajisur me Pëlqim Mjedisor për depon e naftës "Po Petrol" në ngastrën kadastrale me Nr. P-72217022-00746-5 zona kadastrale Mamushë.

A r s y e t i m

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Raportit të VNM-së dhe dokumentacionit përcjellës të Kompanisë "Fariz Mazrek" B.I. Mamushë, Prizren, e cila ka aplikuar për tu pajisur me Pëlqim Mjedisor për depon e naftës "Po Petrol" në ngastrën kadastrale me Nr. P-

Faqe 2 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://ëëë.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



72217022-00746-5 zona kadastrale Mamushë, është konstatuar mungon dokumentacioni si në vijim:

- Mungon Pëlqimi i AME-së;
- Situacioni gjeodezik nga gjeodeti i licencuar për ngastrën: 00746-5;
- Kopja e Planit;
- Certifikata e Biznesit;
- Pëlqimi i Komunës për ushtrimin e veprimtarisë për ngastrën: 00746-5;

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, Neni 17, Paragrafi 2, 3 dhe 4, Kompanisë "Fariz Mazrek" B.I. Mamushë, Prizren, me datën 13.11.2024 është dërguar njoftimi për plotësim të dokumentacionit.

Kompania ka sjell disa nga dokumentet e kërkuara në afatin ligjor, mirëpo pëlqimin e komunës nuk e ka sjell në afatin e përcaktuar ligjor.

Bazuar në të lartcekuat, MMPHI merr vendim për **Përfundimin e Procedurës Administrative** të kërkesës për pajisje me Pëlqim Mjedisor për kompaninë "Fariz Mazrek" B.I. Mamushë, Prizren, e cila ka aplikuar për tu pajisur me Pëlqim Mjedisor për depon e naftës "Po Petrol" në ngastrën kadastrale me Nr. P-72217022-00746-5 zona kadastrale Mamushë.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 24/6068/1- ZSP/ /25 datë: 21.01.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Komunës së Mamushës
5. Kabinetit të Ministrit
6. Divizionit për komunikim me publikun
7. Arkivit të MMPHI



U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të
MMPHI

Faqe 3 nga 3